

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-26-3772-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së-25**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Liri - Med
NUI	810434209
Adresa	Agim Ramadani Nr. 80
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	-10000
Numri Telefonit	045 10 10 25
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lirim Mustafa
Adresa elektronike	tenders@lirimed.com
Data e parashtrimit të ankesës	23.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

LOT 4fluphenazine

Data e njoftimit për kontratë: 20.05.2026

Hapja e ofertave: 16.06.2026

Njoftimi mbi vendimin dt.13.07.2026

Kërkesa për rishqyrtim: 16.07.2026

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 20.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim dhe vendimi refuzues

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 56.3 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar me dt.13.07.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për Lot 4 është rekomanduar për kontratë OE SCHEHAM SH.P.K., ndërsa ne jemi shpall si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Operator Ekonomik Liri - Med, 810434209 Lot 4 ofertues keni paraqitur ofertë me çmim më të lartë se çmimi i përcaktuar në Listën Zyrtare të Çmimeve, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë me Vendimin nr. 63/IV/2026, me nr. prot.05-3086, të datës 27.04.2026.

Sipas pikës III të këtij vendimi, qarkulluesit me shumicë dhe pakicë obligohen t'u përmbahen çmimeve të produkteve medicinale të përcaktuara në Listën Zyrtare të Çmimeve, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Arsyetimi i lartcekur i autoritetit kontaktues është i pabazuar dhe në kundërshtim me kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit. Në dosje të tenderit nuk është përcaktuar askund se operatorët ekonomik janë të obliguar t'u përmbahen çmimeve të Listës Zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, pra nuk është specifikuar që ofertat të hartohen sipas këtij

vendimi dhe as nuk është paraparë se tejkalimi i këtyre çmimeve përbën bazë për eliminimin e ofertës. Prandaj autoriteti kontraktues nuk mund dhe nuk është dashur të na eliminoj me një arsyetim të tillë, pra për një kërkesë e cila nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit. Në këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së, sepse na ka eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit, ndërsa në paragrafin 3 të dispozitës së lartcekur specifikohet qartë “3. *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*”.

Duhet cekur fakti se oferta jonë është me çmim më të ulët se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe njëkohësisht është brenda vlerës së parashikuar nga autoriteti kontraktues.

Në rast se autoriteti kontraktues ka konsideruar se çmimet e Listës Zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë janë të detyrueshme për këtë procedurë, atëherë kjo është dashur të përcaktohej qartë në dosjen e tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomik të përgatisnin ofertat e tyre mbi të njëjtat kushte.

Kur kemi parasysh faktin që kërkesa në lidhje me respektimin e Listës Zyrtare të Ministrisë nuk është specifikuar fare në dosje të tenderit, atëherë kërkojmë që vendimi i AK-së për Lot 4 të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim, me qëllim që oferta jonë të rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe të nxirret një vendim meritator duke u bazuar në kërkesat që janë specifikuar në dosje të tenderit.

Ne me dt.20.07.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që AK-ja në asnjë mënyrë nuk ka dhënë ndonjë fakt apo dëshmi konkrete për të dëshmuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, por janë dhënë arsyeime krejtësisht abstrakte.

Lidhur me arsyetimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, theksojmë se vendimi është nxjerrë pa u shqyrtuar fare pretendimet tona konkrete, pasi që në arsyetimin e vendimit, AK e përmend se kinse pretendim i yni ka qenë që është paraqitur kërkesë për ndryshimin e çmimit dhe se një kërkesë e tillë nuk e pezullon zbatimin e Listës Zyrtare të Çmimeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Mirëpo një konstatim i tillë nuk ka qenë në asnjë moment pretendim i yni ankimor në kërkesën për rishqyrtim, e po ashtu ne as nuk kemi pretenduar se Lista Zyrtare nuk është në fuqi, as se kërkesa për ndryshimin e çmimit e pezullon zbatimin e saj.

Pretendimi ynë i vetëm ka qenë në dosje të tenderit nuk është specifikuar askund që ofertat e OE duhet të hartohen sipas Listës Zyrtare të Çmimeve dhe po ashtu dosja nuk parasheh eliminimin e operatorëve ekonomik në rast se të njëjtit bëjnë tejkalimin e këtyre çmimeve.

Autoriteti kontraktues në vend që t'i përgjigjej këtij pretendimi konkret, e njëjta ka ndërtuar tërë arsyetimin mbi një çështje që nuk është ngritur fare nga ne. Një qasje e tillë nga ana e AK-së tregon qartë se kërkesa jonë për rishqyrtim nuk është analizuar në mënyrë profesionale dhe nuk janë shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore.

Si përfundim vendimi për refuzimin e kërkesës është i paarsyetuar, pasi që nuk është dhënë asnjë përgjigje në lidhje me pretendimet tona ankimore të ngritura në kërkesë, respektivisht nuk është dhënë asnjë arsyetim konkret se në cilën pjesë të dosjes së tenderit është përcaktuar kërkesa në lidhje me respektimin e Listës Zyrtare të Çmimeve dhe as mbi cilën bazë ligjore është eliminuar oferta jonë për një kriter që nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, është tendencioz dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, e për më tepër i njëjti vendim është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, paragrafi 9 ku specifikohet qartë se *“Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”*.

Neni 59.4 i LPP-së e përcakton qartë *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Në këtë rast tenderi ynë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj duhet të konsiderohet oferta jonë e përgjegjshme, në të kundërtën çdo veprim i AK-së është kundërligjor.

Oferta jonë është përgjegjshme edhe sipas nenit 40.6 të RRPP Nr.001/2022.

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së

tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **“Liri-Med” SH.P.K.**

II. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës për **Lot 4** dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së..

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*